



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	05.03.2025
Referencë	11-344/2
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-shkurt

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit shkurt Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit shkurt kanë inspektuar biznese të ndryshme afariste. Objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, urdhëresat për pranim teknik, realizimi i pranimeve teknik të lokaleve në të cilat realizohet veprimtari biznesore.

Pjesë e agjendës se inspektorëve të tregut ka qenë inspektimi i marketeve. Është kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e produkteve.

Në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë identifikuar dhe janë ndaluar disa persona të cilët ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit, të dhënies me qera të veturave për qytetarët. Ndaj të cilave është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan..

Gjatë muajit shkurt është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobilieve. Nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në fshatin Kraishtë, pastaj në kodrën e Kërçevës dhe në deponi të tjera në vazhdimsi, ku edhe janë gjetur dëshmi të mbeturinave të hedhur nga një subjekt me seli në Prishtinë. Ndajë subjektit është shqiptuar gjobë mandatorë dhe i është dhënë urdhëresë për grumbullimin, largimin dhe dërgimin e tyre në deponi legale. Pas rikontrollës dhe fotove të dërguar në inspektorat nga përgjegjësi i subjektit u pa se urdhëresa ishte zbatuar

Subjekti me aktivitet prodhimi i dritareve nga plastika në lokalet e ish Fabrikës se letrës, për shkak të mbeturinave të hedhura në zonën e puseve të ujit të pijes te ish fabrika e letrës i është dhënë urdhëresë largimin e mbeturinave nga vendi i hedhjes, në të kundërtën pasojnë masa ligjore, do të bëhet rikontrollë për zbatim të urdhëresës

Sipas ankesave nga banorë të fshatit Smallushë për ndotje të ajrit me pluhur gjatë qarkullimit të kamionëve të gurorëve, janë ndaluar kamionët për të qarkulluar dhe janë urdhëruar që menjëherë të ujitet rruga me ujë. Urdhëresa është zbatuar nga subjekti.

Janë pranuar ankesa nga qytetaret në fshatin Leletiq, Shalë, Ribarë i Madh, Gadime e Ulët, Janjevë për problemet me ujëra të zeza, pengesa tjera si pasoj e lëshimit të ujërave, dhe probleme me mbeturina. Ku për të gjitha këto raste është dalë në teren dhe janë duke u zhvilluar procedura.

Është inspektuar për mbeturina një autolarje me seli në F.sh Banullë. Gjatë kontrollës u pa se subjekti nuk i dorëzon mbeturinat në K.Pastrimi por ato i hedhë në pronën e tij duke shkaktuar ndotje të mjedisit. I është dhënë urdhëresë që mbeturinat t’i dorëzon K. Pastrimi, të bëhet kontratë dhe një kopje të dëshmohet në Inspektorat.

Janë inspektuar dy hekurishte përgjatë rrugës Lipjan-Shtime në f.sh Bujanë, ku ju është tërhequr vërejtja që ndezja e mbeturinave është e ndaluar me ligj dhe nëse takohen apo gjinden dëshmi për ndezje të mbeturinave do të ndëshkohen sipas ligjit.

Inspektorët e trafikut- Në këtë muaj janë kontrolluar firmat të autobusëve, auto-taksive, radio taksive, operatorët-autobusët janë inspektuar për rend të udhëtimit dhe janë urdhëruar që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është e vërtetuar, ndërsa në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari kemi inspektuar vazhdimisht për taksit ilegal dhe për firma të radio taksit që marrin pasagjer pa porosi.

Janë shqyrtuar edhe disa ankesa të bëra në lidhje me firmat e autobusëve për vonesa në orare të cilat i kemi kontrolluar në vendin e ngjarjes dhe kemi vërtetuar se janë duku u respektuar ashtu si janë të lëshuar nga organi komunal.

Inspektori i ndërtimit- ka realizuar inspektime të vazhdueshme në teren përgjatë zonave urbanistike. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore. Ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjës në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shkurt janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspekte për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	117	23	9	2					46	6				50.00€	8	9	11			3
Ambienti	26	10							7	5			1					1	2	
Ndërtimi	44	7			17		3		3	12			2							
Trafiku	69	19						32		6						9			3	
Gjithsej	256	59	9	2	17		3	32	56	29			3	50.00€	8	18	11	1	5	3

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspekte të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.